

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Nr. 08-125/2

23.01.2025

K e r ç o v ë

PROCESVERBAL

Nga seanca e 44-të e Këshillit të Komunës së Kërçovës, e mbajtur më datë 23.01.2025 në hapsirat e Këshillit të Komunës së Kërçovës me fillim në ora 10:00.

Seancën në ora 10:00 e hapi dhe me të udhëhoq kryetari i Këshillit të Komunës së Kërçovës Skender Xhabiri, ndërsa të pranishëm ishin këshilltarët: Kamerr Klosi, Drenuse Dalipi, Filip Mitreski, Mihajlo Daniloski, Violeta Spasenoska, Olgica Poposka, Igor Stojanoski, Daniela Poposka, Anto Trajanoski, Tefik Lutfiu, Valentina Llazaroska, Bojan Stojkoski, Ivanço Bozhinoski, Viktor Aleksoski, Sibel Tufkegji, Abdulla Sejdini, Fortesa Sejdini, Ramazan Zulbeari, Migjen Zendeli dhe Nexhbi Dervishi, Valbona Adili Emini.

Të pranishëm në seancë ishin: Aneta Nasteska - sekretare e komunës, Valdet Selimi, Burim Kadriu, Fisnik Fejza- përfaqësues nga administrata lokale, si dhe gazetarë nga TV „Uskana,,

Kryetari i këshillit për këtë seancë propozoi rendin e ditës si vijojn:

R E N D I I D I T Ë S

1. Propozim Plani financiar vjetorë për vitin 2025 të SHFQ “Kuzman Josifoski Pitu” Kërçovë
2. Propozim Vendim Për huamarrje të brendshme afatgjatë të Komunës së Kërçovës në kuadër të Projektit për Efikasitet Energjetik në Sektorin Publik (PEEJP)
3. Propozim Kalendar Buxhetor i Komunës së Kërçovës për vitin 2025.

4. Propozim Vendim për përcaktimin e vlerës së pikës për rrogat e nënëpunësve administrativ për vitin 2025

5. Propozim Program për rregullimin e tokës ndërtimore për hapsirën e Komunës së Kërçovës për vitin 2025

6. Propozim Program për festat dhe shënimet e ngjarjeve jubilarë dhe datave të rëndësishme në Komunën e Kërçovës për vitin 2025.

7. Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim i Planit Urbanistik për lagjen Deviço- pjesë, sjellur me vendim në këshill nr.07-1320/2 nga dt.07.09.2000, për PK.nr.5476/1 për KK Kërçovë 9, në Komunën e Kërçovës.

8. Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim i Dokumentacionit Urbanistik për vendin e banuar Strellcë sjellur me vendim në këshill nr.07-194/4-1 nga dt.06.07.2001, për PK.nr.1924/1 KK Strellcë, në Komunën e Kërçovës.

9. Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet dokumentacion urbanistik për PK nr.5412/1, KK Kërçovë jashtë r.n për përcaktimin e objektit pa leje.

10. Propozim Vendim për fillimin e procedurës për hartimin e PDU-së për zonën industriale “NENKRUSHINE“, NJU “Z“, Blloku “Z-5“ – pjesë 1, Komuna e Kërçovës.

11. Propozim Vendim për fillimin e procedurës për hartimin e Projektit urbanistik jashtë perfshirjes së planit urbanistik për formimin e parceles ndërtimore me destinim A4.7 – shtëpi për nevojat e turizmit vendor në PK.nr. 666/3 dhe pjesë nga PK.nr. 666/4, KK Dobrenoec – Komuna e Kërçovës

12. Të ndryshme.

Mihajlo Daniloski - Kërkoj tërheqjen e pikës së gjashtë nga propozimi i rendit të ditës për shkak të mos mbajtjes së Komisionit për festa dhe manifestime dhe dhënien e mirënjohjeve dhe çmimeve komunale. Ai informon se Programi është zhvilluar pa pjesëmarrjen e qytetarëve dhe institucioneve përkatëse. Ai theksoi se më shumë ka shërbyer për promovim politik sesa për promovim të ngjarjeve historike dhe për këto arsye kërkon që pika të hiqet nga rendi i ditës për këtë seancë.

Abdulla Sejdini - Informon se ky program ka qenë në rend dite edhe vitin e kaluar por është tërhequr. Ai theksoi se ka propozuar një amendament në program dhe grupi i

këshilltarëve që ka kërkuar tërheqjen e kësaj pike ka propozuar dy amendamente me data dhe janë pranuar. Nuk e dinte pse kërkonin tërheqjen e pikës. Ai informoi se këshilltarët ishin përfaqësues të qytetarëve dhe i përfaqësonin ata dhe se programi nuk ishte promovim politik dhe pyeti se për cilin promovim politik e kishte fjalën këshilltari.

Mihajllo Daniloski - Informon se kanë qenë këshilltarë për 4 vite dhe vitin paraprak Këshilli nuk ka miratuar një program të tillë. Ai theksoi se në program është paraparë 24 marsi - dita e bashkimit të komunave rurale në një njësi territoriale, Komuna e bashkuar e Kërçovës, por ajo datë ka qenë e lidhur me diçka tjetër. Po ashtu ishte caktuar 17 shkurti – Dita e Pavarësisë së Kosovës, e cila ishte festë e një shteti tjetër dhe ne nuk e festojmë. Ai mund të kishte propozuar 8 majin, ditën kur BDI hyri në koalicion.

Abdulla Sejdini - Informon se 24 marsi është data kur komuna e Kërçovës është bashkuar me të gjitha komunat rurale. Këto ishin zgjedhjet e para për bashkimin territorial të të katërve në një bashki dhe nuk kishte asnjë konotacion politik, por një organizim të ri territorial. Ai theksoi se kjo ka domethënie për të gjithë dhe se komuna e Kërçovës nuk është e ndarë etnikisht, por është komunë e të gjithë kërçovarëve dhe amendamenti është që të gjithë qytetarët të festojnë së bashku. Sa i përket 17 shkurtit, Ditës së Pavarësisë së Kosovës, ai ka theksuar se shteti e ka njohur pavarësinë e Kosovës dhe se atë nuk e njeh vetëm ministri Stoilkoviç. Ai pyeti nëse Mihajlo e njeh Kosovën si shtet të pavarur apo jo.

Mihajlo Daniloski - Informon se 17 shkurti është domethënës për Kosovën dhe se më 9 tetor Maqedonia e njohu pavarësinë e Kosovës. Ai theksoi se nuk ishte festë lokale që komuna ta festonte. Ai theksoi se më 21 shtator, në festën e “Mala Bogodorica”, Drugova u bë komunë, por nuk kërkuan që të festohet dhe atëherë mbaheshin zgjedhjet lokale. Në vitin 2004 u mbajt referendumi për të mbajtur të pavarur komunat Drugovë, Vraneshticë, Zajas dhe Oslome, por ai dështoi dhe nuk kishte nevojë as të festohet.

Abdulla Sejdini – Bën me dije se 24 prilli ishte i rëndësishëm për komunën. Kundërshtimi i Mihajlos për bashkimin e komunave ishte interesi i tij personal dhe jo i përgjithshëm. Ai theksoi se bashkimi i komunave është real dhe duhet pranuar dhe festuar. Vetëm Stoilkoviçi nuk e pranoi Kosovën, por duhej ta pranonin edhe realitetin. Ai ka bërë të ditur se mund të propozojnë data përmes amendamenteve dhe se janë në pritje që amendamenti i tyre të miratohet nga këshilltarët. Ai theksoi se në program janë pranuar edhe 11 shtatori – dita e çlirimit të Kërçovës dhe 23 shtatori – dita e hapjes së shkollës së parë në gjuhën maqedonase në fshatin Podvis. Arsyeja e

tërheqjes së tij nga rendi i ditës nuk ishte e justifikuar dhe të gjitha datat e propozuara në program duhej të ishin pranuar.

Drenushe Dalipi - Kërkoj që pika e parë të hiqet nga rendi i ditës, duke theksuar se e njejta duhet të vendoset në rend dite sipas statutit dhe rregullores pas 6 muajsh.

Igor Stojanoski - Informon se edhe ai kërkon që edhe pika e gjashtë të tërhiqet nga rendi i ditës, sepse beson se e njejta duhet të përgatitet profesionalisht. Ai ka theksuar se është dashur t'u përmbahen ditëve jopune të parapara nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale. Gjithashtu theksoi se në program ka pasur lëshime sa i përket shumës së mjeteve të ndara për festat e fundvitit. Në nenin 9 të Statutit të Komunës thuhet se 11 shtatori – dita e çlirimit të Kërçovës – ishte edhe festë e Komunës dhe për të janë ndarë 30 mijë denarë, shumë pesë herë më e vogël se shuma e ndarë për festat tjera. Uebfaqja e komunës së Kërçovës kishte një tabelë që tregon se kush dhe si përfaqësohet popullata rezidente dhe jorezidente. Sipas regjistrimit të vitit 2021. Ishin 15 boshnjakë dhe ishin të përfaqësuar në program, ndërsa ishin 70 serbë dhe festa e tyre e Shën Savës më 27 janar nuk ishte përfshirë në program. Vetëm serbët janë lënë jashtë. Ai kërkoj që kjo të plotësohet dhe Komisioni të shqyrtojë mjetet që janë propozuar dhe të propozohen sipas rëndësisë së festës.

Kryetari i Këshillit – bën me dije se Mihailo ka thënë se nuk është konsultuar askush në përgatitjen e programit, por nuk është kështu, janë konsultuar institucionet e kulturës dhe duhet të aplikojnë me projekte dhe të përfshihen në program. Janë konsultuar edhe shoqatat kulturore se cilat festa të festohen. Ishte e papranueshme që ky program të ishte etnik dhe të mos manipulohet me data që ndoshta askush nuk i dinte. Ai duhet ta dinte që shqiptarët jetojnë përkrah tyre dhe se identiteti nuk duhet t'i ndalojë. Nuk duhej menduar për ndarje e përçarje, por përkundrazi që të gjithë të jetonin bashkë dhe datat e asnjë etnie të mos i pengonin. Jo për t'u përfshirë në gjëra që nuk ishin të vlefshme, por për të respektuar të gjithë dhe për të mos pasur politikë këtu.

Valentina Lazarevska - Replikë Drenushës për tërheqjen e pikës së parë, si mund të tërhiqet meqenës është miratuar Buxheti. Plani financiar është përfshirë në Buxhet dhe nuk duhej të tërhiqej, sepse ishte në të. Programi i festave duhej të pasqyronte traditat kulturore dhe historike të komunës. Përfshirja e ngjarjeve nga vende të tjera mund të konsiderohej si paragjykim politik dhe ata duhet të ishin fokusuar në ngjarje që do të bashkonin qytetarët tanë.

Drenushe Dalipi - Informon se kjo pikë ka qenë në seancën e kaluar dhe nuk është miratuar, tani është dashur që të miratohet pas 6 muajsh. Komunës i janë hequr disa nga përgjegjësitë në arsim dhe duhet të kërkojnë që të miratohet nga ministria.

Valentina Lazareska - Informon se kompetenca i është hequr për emërimin e drejtorëve dhe dhënien e pëlqimit. Ajo theksoi se shkollat ishin të lidhura dhe kjo mund të kishte bërë që të mos marrin paga të gjitha shkollat.

Ivanço Bozhinoski – Pyeti se nëse të gjitha shkollat vërtet nuk mund të merrni rroga.

Burim Kadriu - Informon se mos miratimi i planit për shkollën mund të ketë implikime vetëm për atë shkollë. Ai ka theksuar se vetëm ajo shkollë nuk do të mund të financohet, ndërsa jo edhe shkollat tjera. Sipas Ministrisë së Arsimit, ishte e nevojshme që të eliminoheshin mangësitë në plan dhe i njëjti të sillet në këshill.

Valentina Lazarevska - Pyeti se a ju kujtohet kur është rritur vlera e pikëve, për shkak të gabimeve në llogaritjen e pikëve, shkollat në Zajas dhe Drugovë dhe shkollat e tjera nuk kanë marrë rrogë.

Burim Kadriu - Informon se krahasimi nuk është i njëjtë dhe këtu nuk ka pasur llogaritje të duhura, bëhet fjalë për një plan financiar dhe shkollat e tjera do të financohen.

Kryetari i Këshillit - Informon se ka kërkesë nga Drenusha për tërheqjen e pikës së parë nga rendi i ditës. Ai kërkoi që të mendohen mirë që të mos ishin ato pengesë për marrjen e rrogave në shkollë.

Drenushe kërkoi 5 minuta pushim. Pas pushimit seanca vazhdoi.

Kryetari i këshillit i ka bërë thirrje Drenushës që të deklarohet.

Drenushe Dalipi – Informon se qëndron në atë që pika e parë e rendit të ditës të tërhiqet.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim tërheqjen e pikës së parë të rendit të ditës: Propozim Planit financiar vjetorë për vitin 2025 të SHFQ “Kuzman Josifoski Pitu” Kërçovë dhe u miratua me 14 vota PËR. 8 vota KUNDËR.

Më pas, Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim tërheqjen e pikës së gjashtë nga rendi i ditës: Propozim Program për festat dhe shënimet e ngjarjeve jubilarë dhe datave të rëndësishme në Komunën e Kërçovës për vitin 2025 dhe nuk u miratua me 8 vota PËR. 12 vota KUNDËR dhe 3 vota PËRMBAJTUR.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim rendin e ditës për këtë seancë me pikën e parë të tërhequr dhe u miratua me 16 vota PËR. 7 vota KUNDËR. PËRMBAJTUR (asnjë).

Kalohet në:

2. PIKA E DYTË: Propozim Vendim Për huamarrje të brendshme afatgjatë të Komunës së Kërçovës në kuadër të Projektit për Efikasitet Energjetik në Sektorin Publik (PEEJP)

Burim Kadriu - Bën me dije se një vendim i tillë është marrë në nëntor të vitit të kaluar, por koha për zbatimin e tij ka qenë e shkurtër dhe tani është dashur të miratohet sërish me projekte të listuara konkrete në të. Ai theksoi se ka pasur dy projekte, përkatësisht për shkollën fillore "Sande Šterjoski" dhe për shkollën fillore "Vladimir Poležinoski", dhe mjetet duhet të paguhen për 6 vjet, duke përfshirë periudhën 1-vjeçare „grejs,,.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim Për huamarrje të brendshme afatgjatë të Komunës së Kërçovës në kuadër të Projektit për Efikasitet Energjetik në Sektorin Publik (PEEJP) dhe u miratua me 23 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

3. PIKA E TRETË: Propozim Kalendar Buxhetor i Komunës së Kërçovës për vitin 2025.

Burim Kadriu - Informon se në Kalendarin Buxhetor janë paraparë datat e aktiviteteve lidhur me përgatitjen dhe zbatimin e Buxhetit.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Kalendar Buxhetor i Komunës së Kërçovës për vitin 2025 dhe i njehti u miratua me 23 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

4. PIKA E KATËRT: Propozim Vendim për përcaktimin e vlerës së pikës për rrogat e nënëpunësve administrativ për vitin 2025.

Burim Kadriu - Informoi se vlera e pikës është duke u përcaktuar në përputhje me rregulloret ligjore dhe ka shpjeguar vendimin.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim për përcaktimin e vlerës së pikës për rrogat e nënëpunësve administrativ për vitin 2025 dhe është miratuar me 23 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

5. PIKA E PESTË: Propozim Program për rregullimin e tokës ndërtimore për hapsirën e Komunës së Kërçovës për vitin 2025

Fisnik Fejza – Informon se sipas ligjit është e nevojshme të përgatitet një program i tillë dhe i njejtë është dorëzuar. Ai theksoi se programit i janë shtuar edhe tri pika dhe shtesa u është dorëzuar këshilltarëve.

Mihajlo Daniloski - Ai kërkoi që zbatimi i programit për rregullim të jetë më i madh. Ai pyeti se sa ka përparuar ndërtimi i kanalizimit fekal, në të cilin ishin përfshirë Drugova, Premka, Zajazi e të tjerë.

Fisnik Fejza - Informon se Programi është gjithëpërfshirës dhe përfshin projekte me rëndësi për qytetarët. Vlen të përmendet se ata përgatitën projektin e ujërave të zeza, aplikuan dhe morën grant. Ministria e Financave vendosi për atë se deri ku është realizimi. Ai kërkoi që ta kontaktojë Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Mjedisit Jetësorë për një përgjigje.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Предлог Програмата за уредување на градежно земјиште на просторот на Општина Кичево за 2025 dhe i njejtë u miratua me 23 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

6. PIKA E GJASHTË: Propozim Program për festat dhe shënimet e ngjarjeve jubilarë dhe datave të rëndësishme në Komunën e Kërçovës për vitin 2025.

Igor Stojanoski - Informon se në Program nuk ka pasur përfaqësim adekuat të bashkësive etnike. Ai ka theksuar se ka rezerva për përvjetorin e Lidhjes së Prizrenit, sepse bie ndesh me dispozitat kushtetuese të vendit tonë. Ai nuk e dinte nëse të gjithë e dinin se pse po festonin. Programi deklaronte se ishte një organizim politik dhe ushtarak dhe se ngjarja ishte domethënëse për Republikën e Shqipërisë. Ai informon se ne jemi në Republikën e Maqedonisë dhe jo në Shqipëri, prandaj kërkoi që programi të tërhiqet. Nuk e dinte pse ishte përfshirë në program. Dhe më 17 shkurt, pse një shtet sovran i njohur nga shumë vende do të festonte pavarësinë e një vendi tjetër? Ai gjithashtu beson se shpërndarja financiare e mjeteve janë të imponuara. Diku kishte sasi më të mëdha, e diku më të vogla, si p.sh. për të shënuar 8 shtatorin, 11 shtatorin etj. Ai theksoi se 8 shtatori është dita e pavarësisë së vendit tonë dhe duhet të festohet, prandaj duhet të ndahen më shumë mjete.

Abdulla Sejdini - Replikë për kolegun për 10 qershorin, përvjetorin e Lidhjes së Prizrenit. Ai informon se bashkëjetesa është e nevojshme. Lidhja e Prizrenit u themelua në vitin 1878. Kur ne nuk ekzistonim, ekzistonte një mbretëri. Ai u bëri thirrje këshilltarëve që të mos ndajnë datat, por t'i forcojnë ato. Nëse kjo nuk do të mbështetej, do të përthithej në etninë shqiptare. Ishte e nevojshme që të gjithë të punonin së bashku dhe të mbështesin njëri-tjetrin.

Igor Stojanoski - Informon se nuk ka thënë asgjë nga këto në mënyrë simptomatike dhe nuk ka përmendur ndarje. Ai theksoi se prej 3 vitesh kërkon që pankartat për mirëseardhjen e mërgimtarëve të vendosen edhe në gjuhën maqedonase. Gjithmonë sillej mirë dhe ishte për bashkëjetesë. Lexoi një pjesë të Programit. Citim: "Kjo ngjarje është domethënëse për historinë kombëtare të Shqipërisë." Ai ka hulumtuar dje në internet dhe ka parë që ajo datë nuk ishte planifikuar as për festë në Shqipëri. Ai bëri të ditur se ajo datë nuk ishte në përputhje me Kushtetutën e vendit tonë dhe kërkoj që shërbimet ligjore ta hetojnë këtë dhe ta korrigjojnë nëse nuk është kështu.

Abdulla Sejdini – Informon se nuk ka dyshim për këtë, por dyshimi është për vitin 1878. dhe nuk duhej të merreshin me këtë, sepse nuk kishte solidarizim me popullin shqiptar.

Ivanço Bozhinoski - Informon se diskutimi ka shkuar në një drejtim tjetër dhe është dashur t'i kushtohet vëmendje bashkëjetesës në Kërçovë. Si këshilltarë po dërgonin një mesazh të keq dhe duhej të kishin kujdes se çfarë diskutonin, sepse kishte edhe media që e ndiqnin. Ata pranojnë Ditën e Flamurit Shqiptar, datën e shkollës së parë në gjuhën shqipe. Vendimin për festimin e pavarësisë së Kosovës e ka marrë Qeveria, jo ata. Ai ka theksuar se si grup këshillëdhënës nga LSDM-ja do ta përkrahin Programin nëse Lidhja e Prizrenit përjashtohet nga ai, por jo ndryshe.

Mihajlo Daniloski - Informon se në pajtim me nenin 172 të Rregullores së punës, këshillit i dorëzon me shkrim 5 amendamente nga grupi i këshilltarëve të VMRO-DPMNE-së dhe në pajtim me nenin 174 të së njëjtës Rregullore ka kërkuar ndërprerje të e seancës që të shqyrtohen. Ai kërkoj që datat 10 qershor, 17 shkurt dhe 24 mars të hiqen nga Programi dhe t'i shtohen programit datat 8 dhjetor, 8 mars dhe 23 tetor. Ai ka theksuar se në përputhje me nenin 41, paragrafi 3 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, çështjet kulturore duhet të votohen me badinter.

Kryetari i Këshillit – Informon se amendamentet është dashur të dorëzohen me kohë, tani do t'i lexojë dhe do t'i vendosë për miratim.

Amendamenti 1

Plotësim i programit me datën 23 Tetor - Dita e Luftës Revolucionare Maqedonase

Amendamenti u lexua nga kryetari i Këshillit, duke theksuar se për përkujtimin e tij janë propozuar 100.000 denarë.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim amendamentin e propozuar dhe nuk u miratua me 8 vota PËR. 12 vota KUNDËR. 3 vota PËRMBAJTUR.

Amendamenti 2

Plotësimi i programit me 8 Dhjetor - St. Klementi i Ohrit

Pas leximit të kuptimit të festës, Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim dhe nuk u miratua me 10 vota PËR dhe 12 vota KUNDËR. 1 votë PËRMBAJTUR.

Plotësimi i programit me 8 Marsin - Ditën Ndërkombëtare të Gruas

Pasi u lexua, Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim dhe nuk u miratua me 11 vota PËR. 12 vota KUNDËR. PËRMBAJTUR (asnjë).

Amendamenti 3

Ndryshimi i programit: 17 Shkurti – Dita e Pavarësisë së Kosovës, të mos përfshihet në program

Pas leximit të amendamentit, Kryetari i Këshillit e vuri për miratim dhe nuk u miratua me 8 vota PËR. 12 vota KUNDËR. 3 vota PËRMBAJTUR.

Amendamenti 4

Ndryshimi i programit: 24 marsi - Dita e bashkimit të komunave rurale në një njësi territoriale - Komuna e bashkuar e Kërçovës, të hiqet nga programi.

Pas leximit të amendamentit, Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim dhe nuk u miratua me 8 vota PËR. 12 vota KUNDËR. 3 vota PËRMBAJTUR.

Amendamenti 5

Ndryshimi i programit: 10 Qershor-Përvjetori i Lidhjes së Prizrenit, të mos jetë në program.

Kryetari i këshillit, pasi e lexoi amendamentin, e vendosi për miratim dhe nuk u miratua me 11 vota PËR. 12 vota KUNDËR. PËRMBAJTUR (asnjë).

Igor Stojanoski - Informon se ky program është pjesë e programit për kulturë. Sipas të dhënave nga regjistrimi i fundit i popullsisë në vitin 2021 të cilat janë tabeluar në ueb faqen, në Komunën e Kërçovës, nga numri i përgjithshëm i popullsisë rezidente, 353 shqiptarë janë më shumë se sa maqedonas. Në nenin 41, paragrafi 3 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, citoj: “Rregulloret që kanë të bëjnë me kulturën, përdorimin e gjuhëve dhe shkrimeve që flasin më pak se 20% e qytetarëve në komunë, përcaktimi dhe përdorimi i stemës dhe flamurit të komunës, miratohen me shumicën e anëtarëve të këshillit të pranishëm, me shumicë votash të pranishëm në këshill që nuk janë

popullsia shumicë në komunë.” Meqë sipas regjistrimit maqedonasit nuk janë popullatë shumicë, ai kërkoi që ky nen të merret parasyshtë.

Mihajlo Daniloski - Ai ka kërkuar që të votohet sipas badinterit, në pajtim me nenin 41, paragrafi 3 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, sepse ai program është kulturor.

Kryetari i Këshillit - njofton se nuk e pranon dhe e vendos për miratim Propozim Program për festat dhe shënimet e ngjarjeve jubilarë dhe datave të rëndësishme në Komunën e Kërçovës për vitin 2025 dhe është miratuar me 12 vota PËR. 11 vota KUNDËR. PËRMBAJTUR (asnjë).

Kryetari i këshillit dha një pushim prej 5 minutash. Pas pushimit seanca vazhdoi.

Mihajlo Daniloski - Informon se për shkak të mos respektimit të nenit 41, paragrafit 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, grupi i këshilltarëve nga VMRO-DPMNE dhe koalicioni do të largohen nga seanca.

Këshilltarët nga VMRO-DPMNE dhe koalicioni e lanë seancën.

Abdulla Sejдини – Bën me dije se në historikun e formimit të këtij këshilli, propozuesi i amendamentit largohet nga seanca dhe nuk do të votojë.

Kryetari i Këshillit – Informoi se kishte të drejtë, por gjithsesi ishte e drejtë e tyre.

7. PIKA E SHTATË: Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim i Planit Urbanistik për lagjen Deviço- pjesë, sjellur me vendim në këshill nr.07-1320/2 nga dt.07.09.2000, për PK.nr.5476/1 për KK Kërçovë 9, në Komunën e Kërçovës.

Fisnik Fejza – Informon se pikat 7-11 janë nga fusha e urbanizmit. Ai informon se bëhet fjalë për legalizimin e një objekti që ishte jashtë planit urbanistik. Duhej të sillet vendim nga Këshilli për përfshirjen e objektit.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim i Planit Urbanistik për lagjen Deviço- pjesë, sjellur me vendim në këshill nr.07-1320/2 nga dt.07.09.2000, për PK.nr.5476/1 për KK Kërçovë 9, në Komunën e Kërçovës dhe e njejta u miratua me 14 vota PËR, KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

8. PIKA E TETË: Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim i Dokumentacionit Urbanistik për vendin e banuar Strellcë sjellur me vendim në këshill nr.07-194/4-1 nga dt.06.07.2001, për PK.nr.1924/1 KK Strellcë, në Komunën e Kërçovës

Fisnik Fejza – bën me dije se bëhet fjalë për legalizimin e objekteve që janë jashtë përfshirjes urbane.

Ivanço Bozhinoski - Pyet nëse bëhet fjalë për legalizimin e objekteve në pronësi private.

Fisnik Fejza – Informon se në pikat 7, 8 dhe 9 bëhet fjalë për parcela private.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim i Dokumentacionit Urbanistik për vendin e banuar Strellcë sjellur me vendim në këshill nr.07-194/4-1 nga dt.06.07.2001, për PK.nr.1924/1 KK Strellcë, në Komunën e Kërçovë dhe e njehta u miratua me 14 vota PËR, KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

9. PIKËN E NËNTË: Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet dokumentacion urbanistik për PK nr.5412/1, KK Kërçovë jashtë r.n për përcaktimin e objektit pa leje.

Fisnik Fejza – bën të ditur se bëhet fjalë për legalizim të objekteve dhe për këtë ka pasur edhe elaborat. Duhej një vendim nga Këshilli.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet dokumentacion urbanistik për PK nr.5412/1, KK Kërçovë jashtë r.n për përcaktimin e objektit pa leje dhe u miratua me 14 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

10. PIKA E DHJETË: Propozim Vendim për fillimin e procedurës për hartimin e PDU-së për zonen industriale “NENKRUSHINE“, NJU “Z“, Blloku “Z-5“ – pjesë 1, Komuna e Kërçovës.

Fisnik Fejza – bën me dije se bëhet fjalë për propozim për inicimin e procedurës për përgatitjen e PDU-it në “NËNKRUSHINË”. Ka qenë në zonën B dhe është në pronësi private dhe është me vetëfinancim, dhe jo nga Komuna.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim për fillimin e procedurës për hartimin e PDU-së për zonen industriale “NENKRUSHINE“, NJU “Z“, Blloku “Z-5“ – pjesë 1, Komuna e Kërçovës dhe u miratua me 14 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

11. PIKA E NJËMBËDHJETË: Propozim Vendim për fillimin e procedurës për hartimin e Projektit urbanistik jashtë përfshirjes së planit urbanistik për formimin e parces ndertimore me destinim A4.7 – shtëpi për nevojat e turizmit vendor në PK.nr. 666/3 dhe pjesë nga PK.nr. 666/4, KK Dobrenoec – Komuna e Kërçovës

Fisnik Fejza – bën të ditur se sipas Ligjit për Urbanizëm ka pasur kërkesë nga një person privat i cili do të financojë për të.

Ivanço Bozhinoski - Informon se bëhet fjalë për Restoranin në fshatin Dobrenoec dhe është bërë kërkesë për zgjerimin e parkingut, i cili duhet të miratohet.

Fisnik Fejza – Informon se përveç parkingut është planifikuar edhe ndërtimi i shtëpizave për vikend për zhvillimin e agroturizmit.

Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim për fillimin e procedurës për hartimin e Projektit urbanistik jashte perfshirjes se planit urbanistik per formimin e parceles ndertimore me destinim A4.7 – shtepi per nevojat e turizmit vendor ne PK.nr. 666/3 dhe pjese nga PK.nr. 666/4, KK Dobrenoec – Komuna e Kërçovës dhe u miratua me 14 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

12.PIKA E DZMBËDHJETË: Të ndryshme

Kryetari i këshillit lexoi kërkesat e pranuar.

1. Kërkesë nga B.L Leshnicë për asfaltimin e rrugës nga vendi i quajtur “Revir” deri te stadiumi i fshatit në gjatësi prej 800 metra.

Kryetari i Këshillit informoi se kërkesa duhet të dorëzohet në Sektorin për Veprimtari Komunale.

2. Kërkesë nga banorët e objektit banesorë në rr. “Mito Joveski” nr.5 për zgjidhjen e problemit me nivelimin e bekaton pllakave dhe grumbullimit të ujit përpara objektit të banimit, dhe si pasojë hyrjen e ujit në hapsirat e bodrumit.

U vendos që të zgjidhet kërkesa.

3. Kërkesë nga Shoqata e Qytetarëve të B.L Belicës lidhur me Projektin Bazë të dorëzuar për ndërtimin e objektit të infrastrukturës në linjë dhe realizimin e një pjese të projektit, d.m.th. ndërtimi i një ure dhe risipërfaqja e rrugëve ekzistuese dhe degëve të tyre, si dhe ndërtimi i një muri mbajtës në fazën tjetër.

Është vendosur që kërkesa të dorëzohet në Sektorin për Veprimtari Komunale për veprime të mëtejshme.

4. Kërkesë nga B.L Premkë për sanimin e rrugës në fshat. Premkë, duke përfshirë: tampimin e rrugës në pjesët më të dëmtuara, asfaltimin e të gjithë rrugës, vendosjen e sinjalistikës dhe shenjave përkatëse, përfundimin e ndërtimit të kanalizimit fekal dhe

ndërtimin e një kanali kullues përgjatë rrugës për të parandaluar erozionin dhe dëmtimet e mëtejshme.

5. Kërkesë nga B.L Greshnicë:

1. Kërkesë për asfaltimin e rrugës nga shkolla fillore "Faik Konica" në vendin e quajtur "Revir" me gjerësi 5 metra pas përfundimit të kanalizimit dhe

2. Projektimi dhe ndërtimi i murit mbajtës të xhamia në vendbanimin "Alikurtaj".

U vendos që kërkesa të zbatohet.

Pasi që askush nuk e morri fjalën, dhe me këtë rendi i ditës u shterë për këtë seancë, Kryetari i këshillit e mbylli seancën në ora 14 e 30 minuata.

Procesverbalist

-Lençe Srbinoska

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Kryetar

Skender Xhabiri d.v.

Përkthyes:Tefik Asani

